

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

## Përmbajtja


Raporti i audituesit të pavarur	
Pasqyra e pozicionit financiar .....	1
Pasqyra e performancës financiare .....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto .....	3
Pasqyra e flukseve monetare.....	4
Shënime të pasqyrave financiare.....	5-23

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e performancës financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**


(Shumat në Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Aktivet afatgjata të trupëzuara	5	20,424,952	24,971,487
Aktive afatgjata jo të trupëzuara	5	191,937	233,814
Aktive me të drejtë përdorimi	5.1	39,845,442	58,992,327
Emri i mirë	2(j)	100,146,004	100,146,004
Inventar	5.2	2,817,321	-
<b>Totali i aktive afatgjata</b>		<b>163,425,656</b>	<b>184,343,632</b>
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	6	19,649,058	14,592,830
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	303,478,109	146,663,469
Shpenzime të shtyra	8	2,271,254	2,433,085
Llogari të arkëtueshme të tjera	9	15,573,946	9,820,371
<b>Totali i aktive afatshkurtra</b>		<b>340,972,366</b>	<b>173,509,755</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>504,398,022</b>	<b>357,853,387</b>
<b>Detyrime</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	10	12,235,071	23,332,663
Të pagueshme të tjera	11	65,884,320	40,448,365
Detyrime qiraje	12	19,714,440	18,189,028
Tatim mbi fitimin	18	7,850,712	9,801,291
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>105,684,543</b>	<b>91,771,347</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Detyrime qiraje	12	22,850,235	41,900,448
<b>Detyrimet afatgjata</b>		<b>22,850,235</b>	<b>41,900,448</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>128,534,778</b>	<b>133,671,795</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i nënshkruar	13	1,271,700	1,271,700
Fitim i pashpërndarë		158,070,962	64,838,930
Fitimi i vitit		216,520,582	158,070,962
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>375,863,244</b>	<b>224,181,592</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>504,398,022</b>	<b>357,853,387</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar nga drejtimi i Transcom Worldwide Albania shpk më 13/12/2021 dhe u nënshkruan në emër të saj nga:

  
 Giolguca Corrima  
 Përfaqësues ligjor

**Transcom WorldWide Albania Shpk**  
**NUIS : L 81808502 Q**  
**Rr.Taulantia , Kati 2 , Lagja 1,**  
**DURRES**

  
 PwC Consulting sh.p.k  
 Hartues i pasqyrave financiare

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 23.

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse**  
**për periudhën më 31 dhjetor 2020**

(Shumat në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga kontratat me klientët	14	797,055,847	702,784,013
Të ardhura të tjera	14	1,052,659	42,717
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>798,108,506</b>	<b>702,826,730</b>
Shpenzime për personelin	15	(434,251,608)	(430,640,672)
Shpenzime amortizimi	5	(24,464,317)	(24,011,033)
Shpenzime të tjera operative	16	(75,216,220)	(55,196,205)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>264,176,361</b>	<b>192,978,820</b>
Shpenzime interesi për qiranë		(4,605,607)	(4,546,328)
Humbje nga kursi i këmbimit		(6,196,859)	(3,363,396)
<b>Shpenzime financiare, neto</b>	17	<b>(10,802,466)</b>	<b>(7,909,724)</b>
<b>Fitimi përpara tatimit</b>		<b>253,373,895</b>	<b>185,069,096</b>
Tatim mbi fitimin	18	(36,853,313)	(26,998,134)
<b>Fitimi neto për vitin</b>		<b>216,520,582</b>	<b>158,070,962</b>

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 23.

**Transcom WorldWide Albania sh.p.k**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(Shumat në Lekë)

	<b>Kapitali i nënshkruar</b>	<b>Fitimi i akumuluar</b>	<b>Totali</b>
Gjendja më 31 maj 2018	1,271,700	-	<b>1,271,700</b>
Fitimi i vitit	-	64,838,930	<b>64,838,930</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>1,271,700</b>	<b>64,838,930</b>	<b>66,110,630</b>
Fitimi i vitit	-	158,070,962	<b>158,070,962</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,271,700</b>	<b>222,909,892</b>	<b>224,181,592</b>
Fitimi i vitit	-	216,520,582	<b>216,520,582</b>
Dividend	-	(64,838,930)	<b>(64,838,930)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,271,700</b>	<b>439,430,474</b>	<b>375,863,244</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 deri 23.

**Transcom WorldWide Albania Sh.p.k.**  
**Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(Shumat në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë shfrytëzuese</b>			
Fitimi para tatimit		253,373,895	185,069,096
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizim	5	24,464,317	24,011,033
Shpenzime të përlllogaritura		(4,839,762)	(4,610,753)
Shpenzime interesi sipas IFRS 16		3,389,023	4,540,229
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve materiale		927,991	-
Diferenca nga rivlerësimi		774,556	(952,958)
		<b>278,090,020</b>	<b>208,056,647</b>
<i>Ndryshimet në kapitalin qarkullues:</i>			
Inventari		(2,817,321)	-
Ndryshime në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	7,9	(162,568,214)	(38,126,403)
Ndryshime në shpenzime të shtyra	8	161,831	(1,146,384)
Ndryshime në llogari të pagueshme dhe të tjera	10,11	19,178,123	19,528,193
<b>Totali i ndryshimeve qarkulluese</b>		<b>(146,045,580)</b>	<b>(19,744,594)</b>
Tatim fitim i paguar	18	(38,803,893)	(26,998,134)
<b>Flukset e gjeneruara nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>93,240,547</b>	<b>161,313,920</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje të aktiveve afatgjata të trupëzuara	5	(1,909,093)	(3,948,679)
Shitje e aktiveve materiale	5	252,084	-
<b>Flukset e përdorura për veprimtaritë investuese</b>		<b>(1,657,009)</b>	<b>(3,948,679)</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>			
Pagesa të detyrime të qirasë financiare-principal	12	(18,299,357)	(17,139,446)
Pagesa të detyrime të qirasë financiare-interes		(3,389,023)	(4,540,229)
Dividend te paguar		(64,838,930)	-
Pagesë e huasë		-	(129,591,000)
<b>Flukset e përdorura në veprimtaritë financuese</b>		<b>(86,527,310)</b>	<b>(151,270,675)</b>
Rritja e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to		5,056,228	6,094,565
Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	6	14,592,830	8,498,265
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit</b>		<b>19,649,058</b>	<b>14,592,830</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të paraqitura në faqet 5 dhe 23.

## **1. HYRJE**

Transcom Worldwide Albania sh.p.k (në vijim referuar si “Shoqëria”) është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 8 qershor 2018 nën formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT L81808502Q.

Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga aksioneri i vetëm, Transcom WorldWide AB i cili ka nënshkruar një kapital fillestar prej 1,271,700 Lekë.

Shoqëria e ushtron aktivitetin në adresën Rr “Taulantia”, Lagjia 1, Durrës. Objekti i aktivitetit së Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve telefonike për të tretë.

Numri i punonjësve të Shoqërisë në 31 dhjetor 2020 është 487 (2019: 537).

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17 datë 16.01.2019, në mbështetje të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, një subjekt mund të klasifikohet i rëndësishëm për interesin e publikut (PIE) për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre. Bazuar në pikën IV të këtij vendimi, Transcom Worldwide Albania klasifikohet si PIE për shkak të plotësimit të kritereve.

## **2. BAZA E KONTABILITETIT**

### **a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

#### *Parimi i vijimësisë*

Gjatë vitit 2021, Shoqëria nuk ka pasur devijim nga shifrat e buxhetura. Situata pandemike nuk ka ndikuar në aktivitetin ekonomik të Shoqërisë, e cila deri në nëntor të vitit 2021 ka realizuar të ardhura në shumën 456,685,992 Lekë. Në bazë tre-mujore, të ardhurat kanë qenë si vijon: tre-mujori i parë, 228,991,300 Leke, tre-mujori i dytë, 99,715,657 Lekë, tre-mujori i tretë, 52,370,381 Lekë dhe 75,608,655 Lekë të realizuara gjatë muajit tetor dhe nëntor. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2020 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

### **b) Baza e përgatitjes financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

### **c) Monedha funksionale dhe raportuese**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë shqiptar (Lekë), që është dhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

### **d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme për shkak të këtyre çmuarjeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Vecanërisht, informacioni në lidhje me vlerësimet më të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykimet që lidhen me zbatimin e politikave kontabël të cilat ndikojnë në shumat të konsiderueshme në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

### a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi 2020	Kursi 2019
Kursi mesatar i vitit Lekë/ Euro	123.77	123.00
Kursi i fund vitit Lekë/ Euro	123.70	121.77

### b) Të ardhura nga kontratat me klientët

Shoqëria ofron shërbim suporti me anë të linjes telefonike në gjuhë të ndryshme për palët e lidhura dhe për të tretë. Transcom ofron shërbime të kujdesit ndaj klientit dhe mbështetje teknike nëpërmjet kanaleve të ndryshme si: telefonit e-mail, chat-it etj. Ky shërbim ofrohet kryesisht në industri si: media dhe telekomunikacion, e-commerce, logjistike, shitje me pakicë.

Të ardhurat njihen në një shumë që reflekton shumën për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një konsumator (sipas SNRF 15). Transaksionet e Shoqërisë janë kryesisht me palën e lidhur, për këtë arsye nuk ka pasiguri për ofrimin e shërbimit.

SNRF 15 është zbatuar nga Shoqëria në pasqyrat financiare sic shpjegohet më poshtë:

- *Modifikimet e kontratës:* Shoqëria nuk ka pasur ndonjë ndryshim të kontratave lidhur me qëllimin ose shumën korresponduese të kontratës.
- *Detyrimet shtesë të performancës të identifikuar:* Në përgjithësi, Shoqëria siguron vetëm një detyrim të veçantë të performancës që është suporti me anë të linjës telefonike në gjuhë të ndryshme.
- *Shuma të ndryshueshme:* Çmimi i transaksionit nuk bazohet në shumën e ndryshueshme.
- *Komponentë të rëndësishëm të financimit:* Shoqëria nuk ka dhe nuk pret që të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti tejkalon një vit.
- *Programet e besnikërisë ndaj klientit:* Shoqëria nuk zbaton ndonjë program besnikërie.
- *Përcaktimi i kohës së njohjes së të ardhurave (njohja përgjatë kohës ose njohja në një moment të caktuar kohor):* Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen, pra në një moment të caktuar kohor.
- *Rimbursimet:* Shoqëria nuk zbaton rimbursime.
- *Kostot shtesë të marrjes së një kontratë:* Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto shtesë për të marrë një kontratë.
- *Kostot për të realizuar një kontratë:* Shoqëria nuk ka kryer ndonjë kosto për të realizuar një kontratë.



## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### b) Të ardhura nga kontratat me klientët (vazhdim)

*Kushtet e arkëtimit të të ardhurave:* Faturimi i shërbimit bëhet në bazë mujore dhe termat e pagesave janë 30-60 ditore nga momenti i lëshimit të faturës.

Gjate 2020, Shoqëria ka realizuar të ardhura nga kontratat e lidhura me palë të treta. Të ardhurat njihen për shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta. Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Nëse një palë tjetër përfshihet në ofrimin e mallrave apo shërbimeve tek një klient, njësia ekonomike duhet të përcaktojë nëse natyra e premtimit të saj është një kusht performance për të ofruar vetë mallrat apo shërbimet e specifikuara (d.m.th njësia ekonomike është njësi kryesore) ose për të ndihmuar që pala tjetër të ofrojë ato mallra apo shërbime (d.m.th njësia ekonomike është njësi agjent)

Shoqëria përcakton natyrën e premtimit të saj për qëllimet e zbatimit të SNRF 15 duke:

- Identifikuar mallrat ose shërbimet e specifikuara që duhet t'i ofrohen klientit; dhe
- Vlerësuar nëse ajo ka kontrollin mbi çdo mall ose shërbim të specifikuar para se malli ose shërbimi t'i transferohet klientit.

?

### Balancat kontraktuale

#### *Aktivitet kontraktuale*

Një aktiv kontraktual është e drejta në këmbim të mallrave dhe shërbimeve të transferuara tek konsumatori. Nëse Shoqëria operon duke transferuar shërbimet tek konsumatori përpara se ky i fundit të paguajë ose përpara afatit të pagesës, një aktiv kontraktual njihet në vlerën e pretendimit të përfutur, e cila është e kushtëzuar.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Një llogari e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë ndaj vlerës së një pretendimi të pakushtëzuar (që do të thotë se kërkohet vetëm kalimi i kohës në mënyrë që pagesa e pretendimit të jetë i pagueshëm).

#### *Detyrimet kontraktuale*

Një detyrim kontraktual është detyrimi për të transferuar mallra ose shërbime tek një konsumator për të cilin Shoqëria ka marrë një konsideratë financiare nga konsumatori.. Nëse konsumatori paguan pretendimin përpara se Shoqëria të transferojë mallrat ose shërbimet tek ky i fundit, njihet një detyrim kontraktual në momentin që pagesa është bërë ose kur detyrimi është i pagueshëm (cilado të jetë më e hershme). Detyrimet kontraktuale njihen si të ardhura kur Shoqëria vepron sipas kontratës. Shoqëria nuk merr parapagime nga kontratat me klientët dhe si rrjedhojë nuk ka detyrime të kontratës.

### c) Përfitimet e punonjësve

#### *Sigurimet shoqërore të detyrueshme*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ndodhin.

#### *Leje vjetore*

Të gjithë punonjësit e Shoqërisë, sipas legjislacionit aktual vendor, kanë të drejtë të paguhen për leje vjetore të papërdorur në rast se kontrata e punës është ndërprerë. Gjithsesi, lejet vjetore parashikohet të përdoren nga punonjësit deri në datën 31 mars të vitit pasardhës dhe Shoqëria nuk do duhet të kompensojë financiarisht këtë shumë.

### d) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat (shpenzimet) financiare neto përbëhen nga shpenzimet e interesit dhe nga fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të përealizuara nga këmbimet valutore, të cilat raportohen neto në këto pasqyra financiare.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi-fitimi njihet në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit. Një tatim i shtyrë njihet deri në atë vlerë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivitetet e njohura nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Diferencat e përkohshme midis vlerës së aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale janë jo- materiale për Shoqërinë dhe për këtë arsye Shoqëria nuk llogarit aktive tatimore të shtyra.

### f) Parapagimet

Parapagimet njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktivitetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

### g) Aktivitetet afatgjata të trupëzuara

#### *Njohja dhe vlerësimi*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

#### *Kostot e zëvendësimit*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivitetit vetëm nëse parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për Shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot që rrjedhin nga përdorimi normal i aktiveve afatgjata materiale janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

#### *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet në mënyrë që të shpërndahet kosto e aktivitetit e pakësuar me vlerën parashikuar të mbetur të tij duke përdorur metodën lineare mbi jetën e vlerësuar të dobishme. Aktivitetet me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe e jetës së tyre të dobishme. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata të trupëzuar për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

• Pajisje zyre	5 vjet
• Mobilje	5 vjet
• Pajisje informatike	7 vjet

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen çdo datë raportimi dhe korrigojnë nëse është e nevojshme.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### h) Qiratë

#### *E drejta e përdorimit të aktivitetit*

Shoqëria ka marrë me qira ambiente për zyra që përdoren për qëllimet e aktivitetit të saj ekonomik. E drejta e përdorimit të aktiveve maten me kosto, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi dhe rregullohen për çdo ri-matje të pasiveve të qirasë. Kostoja e të drejtës së përdorimit të aktivitetit përfshin:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose para datës së fillimit minus çdo stimul i marrë nga qiraja;
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për të rikthyer aktivin në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

#### *Amortizimi*

E drejta e përdorimit të aktivitetit përgjithësisht zhvlerësohet për periudhën më të hershmes ndërmjet jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë mbi një bazë lineare. Nëse Shoqëria ka baza të sigurta për të ushtruar një opsion blerjeje, aktiviteti i së drejtës së përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Amortizimi i zërave të aktiveve të së drejtës së përdorimit në lidhje me zyrat është 4 vite dhe llogaritet duke përdorur metodën lineare sipas kushteve të kontratës së qirasë.

#### *Detyrimi i qirasë*

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul i qirasë së arkëtueshme,
- pagesa e ndryshueshme e qirasë që bazohet në një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që pritet të paguhen nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerje nëse Shoqëria në mënyrë të arsyeshme është e sigurt për të ushtruar atë mundësi., dhe
- pagesa të penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron Shoqërinë që ushtron atë opsion.

Pagesat e qirasë zbriten duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërinë, duke qenë norma që Shoqëria do të duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme, në një mjedis ekonomik me terma, kolateral dhe kushte të ngjashme.

Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria zbaton normën e publikuar nga Banka e Shqipërisë për huazimet në euro për pasuri të paluajtshme dhe blerjen e pajisjeve, me një maturim prej 3 deri në 5 vjet. Pagesat e qirasë gjatë gjithë periudhës 5-vjeçare të kontratës për ndërtesën janë të ndryshueshme dhe ndryshojnë në bazë të çmimit për metër katror të sipërfaqes siç është rënë dakord nga palët, duke marrë parasysh çmimet e referencës për qira të ndërtesave për qëllime tatimore, sipas legjislacionit përkatës.

Pas datës së fillimit, shuma e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar akumulimin e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e kryera të qirasë.

Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin themelor.

Pagesat e qirasë alokohen midis kostos kryesore dhe asaj financiare. Kostot e financimit ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### h) Qiratë (vazhdim)

Pagesat e lidhura me qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në fitim ose humbje. Qira afatshkurtra janë qira me afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak. Asetet me vlerë të ulët janë asetet me një vlerë prej 5,000 Eur ose më pak.

*Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me opsionet e rinovimit dhe përfundimit*

Shoqëria përcakton afatin e qirasë si termin e pa-anulueshëm të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të zgjatur qiranë nëse ka baza të sigurta për t'u ushtruar, ose ndonjë periudhë e mbuluar nga një opsion për të përfunduar qiranë, nëse ka baza të arsyeshme që të mos ushtrohet.

Gjatë vitit 2020, për shkak të situatës pandemike, Shoqëria ka përfutur një zbritje në tre nga pagesat mujore të qirasë së ndërtesës. Shuma e kësaj zbritje në total është 734,000 Lekë. Duke marrë në konsideratë vlerën e vogël të zbritjes së ofruar, natyrën jo të zakonshme të saj dhe faktin që një zbritje e tillë nuk do aplikohet në periudhat e ardhshme, Shoqëria e ka kontabilizuar këtë shumë si të ardhura të tjera në vitin 2020.

Në lidhje me kontratën e qirasë për zyrat, qiradhënësi ka të drejtë të njoftojë qiramarrësin jo më vonë se 1 vit para skadimit të afatit të qirasë. Rinovimi do të jetë për të paktën 5 vjet, në varësi të kushteve dhe kushteve të njëjta të përcaktuara në marrëveshjen ekzistuese.

Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje dhe përfundimi. Shoqëria zbaton gjykimin në vlerësimin nëse ka baza të sigurta nëse do të ushtrojë opsionin për rinovimin ose përfundimin e qirasë. Kjo do të thotë, se shqyrton të gjithë faktorët relevantë që krijojnë një nxitje ekonomike për të që të ushtrojë rinovimin ose përfundimin e kontratës. Pas datës së fillimit, Shoqëria rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave që është brenda kontrollit të saj dhe ndikon në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo për të ushtruar mundësinë e rinovimit ose të ndërprerjes.

### (i) Aktivet afatgjata jo të trupëzuara

Aktivët afatgjata jomateriale të blera nga Shoqëria, të cilat përfshijnë programe kompjuterike (software) janë regjistruar me kosto të pakësuar me amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin (në rastin kur aplikohet). Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata jo të trupëzuar për periudhën ekzistuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

- Program kompjuterik 7 vjet

### (j) Emri i mirë

Emri i mirë është krijuar nga transferimi i aktivitetit që Shoqëria ka kryer sipas marrëveshjes së datës 28 qershor 2018. Marrëveshja e transferimit konsiston në transferimin e të gjithë asetëve të Shoqërisë së mëparshme Nethex, kontratave të punonjësve edhe disa kontrata me furnitorët, ndër të cilat më e rëndësishmja kontrata e ambjenteve me qira. Vlera e drejte e aktiveve të identifikueshme që rezultoi të ishte vetëm aktivet e trupëzuara, në total përbëjnë Lekë 22,242,000. Transferimi i aktivitetit është kryer me një çmim prej Euro 950,000 ose Lekë 119,607,000. Emri i mirë është krijuar si diferencë e çmimit të blerjes me aktivet, duke shtuar edhe të gjitha shpenzimet ligjore dhe materiale për arritjen e marrëveshjes së transferimit të aktivitetit. Emri i mirë i njohur është Lekë 100,146,004.

Çdo vit, Shoqëria teston zhvlerësimin e emrit të mirë për ta krahasuar me vlerën e rikuperueshme. Shoqëria ka vendosur që për qëllime fiskale të zhvlerësojë emrin e mirë në masën 15% në përputhje me normat fiskale të aplikuara.

### (k) Instrumentet financiare

Një instrument financiar është çdo kontratë që sjell një aktiv financiar për një shoqëri dhe një detyrim financiar ose instrumenta të kapitalit për një shoqëri tjetër. Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë, përfshijnë llogari të arkëtueshme, para dhe ekuivalente me të, llogari të pagueshme dhe kredi bankare dhe hua të tjera. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit apo instrumenta borxhi në vazhdimësi të aktivitetit.

## 2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### (k) Instrumentet financiare (vazhdim)

#### *Njohja fillestare*

Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivativë maten si më poshtë.

#### *Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

#### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogari të pagueshme fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

#### *Zhvlerësimi*

